

## **ABATRAKT**

### **Ndërmjetësimi si alternativë për zgjidhjen e kontesteve në Kosovë**

**Kandidatja : Miralba Nikçi**

**Mentori : Prof. Dr. Asoc. Rrustem Qehaja**

Ndërmjetësimi si alternativë për tu zgjidhur kontestet është lehtësim i madh si për palët në kontest ashtu edhe për gjykatat e rregullta, të cilat janë të mbingarkuara me lëndë të pazgjidhura. Me anë të këtij punimi do të sqaroj fillimisht rreth ndërmjetësimit e pastaj zhvillimin e tij si alternativë për zgjidhje të kontesteve në Kosovë nga fushën Civile, ashtu siç e pranon edhe legjislacioni aktual në fuqi.

Qëllimi i këtij punimi është që të kuptohet sa më qartë dhe saktë se si mund të arrimë te zgjidhja e kontestit duke përdorur ndërmjetësimin si procedurë jashtëgjyqësore.

Metodologjia: Punimi është mbështetur nga materialet si në referencë. Është përdorur metoda e hulumtimit për të mbledhur dhe paraqitur sa më shumë të dhëna dhe informata lidhur me atë se si ndërmjetësimi është efektiv dhe po ashtu mundësi alternative shumë e mirë për tu përdorur.

Rezultati: Ndërmjetësimi si procedurë alternative, jashtëgjyqësore, ju mundëson palëve që të kontestin e tyre ta zgjidhin në afat të arsyeshëm dhe me një procedurë pa zvarritje. Pos kësaj palët kursejnë kohën e tyre të çmuar duke “ikur” nga zvarritja nëpër gjykata, arrijnë marrëveshje të përshtatshme për të dyja palët dhe nuk prishet raporti mes palëve ( pra nuk kemi një palë humbëse por dy palë të kënaqura me përfundimin e kontestit mes tyre ), marrëveshja ka karakterin e titullit ekzekutiv.

Fjalët kyçe: Palët, zgjidhje alternative, marrëveshje, ndërmjetësuesi, kontesti .